



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __. 01. 2010

(Projekt)

V E N D I M
Nr.1127, datë 08.01.2010

Për

“Shqyrtimin e ankimit administrativ të Mobitel WLC në lidhje me vendimin Nr. 1014 datë 26.12.2008 të AKEP”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

| | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 3. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 4. Z. Ibsen | Elezi | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Marsida Dushku, në mbledhjen e datës 08.01. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, me objekt:

“Shqyrtimin ankimit administrativ të sipërmarrësit Mobitel Wireless Communications, Nr. 228 Prot., datë 03.12.2009”,

mori në shqyrtim materialet shkresore të paraqitura nga Drejtoria Juridike, Drejtoria e Licensimit dhe Drejtoria e Rregullimit Teknik, të përbëra nga:

- Ankim administrativ i sipërmarrësit Mobitel Wireless Communications, shkresë nr. 4577 Prot., datë 03.12.2009 (*Ankimi*);
- Projektvendimi i Këshillit Drejtues “Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Mobitel WLC në lidhje me vendimin Nr. 1014 datë 26..12.2008 të AKEP” (*Projektakti*);
- .Relacioni shpjegues mbi projektaktin, shkresë nr. 4577/2 Prot., datë 30.12.2009 (*Relacioni*);

BAZA LIGJORE:

1. Neni 135 e në vijim i ligjit nr.8584 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*KPrA*);
2. Ligj nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr.9918*);
3. Vendim nr. 288, datë 18. 06. 1999 “Për miratimin e dokumentit të politikës së zhvillimit të telekomunikacionit në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar (*VKM nr. 288*);
4. Rregullore “Për dhënien e Autorizimit Individual”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 510, date 4.11.2008 (*Rregullore AI*);
5. pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (*Rregullorja e Brendëshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
6. Vendim i Këshillit Drejtues nr.194, datë 25.06.2004 (*VKD nr. 194*).

Nga administrimi i fakteve të paraqitura në ankim nga ankimesi, fakteve të paraqitura në materialet shkresore nga drejtoritë e AKEP që kanë trajtuar ankimin, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E H E T se :

1. Mobitel Wireless Communications sh.a., është sipërmarrës që ofron rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike. Me Vendimin e ERT - së është pajisur me licensen Nr. 233/0303 datë 21.03.2003, modifikuar më datë 21.03.2003, modifikuar më datë 19.11.2004, "Për të ngritur, zhvilluar dhe shfrytëzuar Rrjet rural të Telekomunikacioneve për publikun dhe për të ofruar shërbime nëpërmjet tij".

2. Me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, nr.1014 dt.26.12.2008 "Për transpozimin e Licensës së Klasit II Nr.233/0303, modifikuar dt.21.03.2003, modifikuar dt.19.11.2004, të subjektit Mobitel Wireless Communications sh.a.", AKEP-i ka pajisur me autorizim individual operatorin Mobitel Wireless Communications dhe ka shfuqizuar Licensën Nr. 233/0303, datë 21.03.2003.

3. Me shkresën nr. 4577 Prot., datë 03.12.2009, Mobitel Wireless Communications ka depozituar ankimin administrativ në lidhje me transpozimin e Licensës së Klasit të II Nr. 233/0303, datë 21.03.2003.

4. Ankimi, është bërë brenda afateve ligjore të përcaktuara në neni 140 të K.Pr.A pasi Vendimi Nr. 1014 i Këshillit Drejtues të AKEP është i datës 26.12.2008, është protokolluar më datë 02.11.2009 dhe sipërmarrësi Mobitel Wireless Communications ka marrë njoftim më datë 06.11.2009. Ankimi nga ana e sipërmarrësit Mobitel Wireless Communications është paraqitur në datë 03.12.2009. Forma e paraqitjes së ankimit, është sipas parashikimeve të KPrA.

5. Arsyet e ankimit dhe argumentet e Mobitel Wireless Communications (*Mobitel WLC*) për kundërshtimin e Vendimin Nr.1014 datë 26.12.2008 të Këshillit Drejtues të AKEP (*VKD nr. 1014*), janë:

- Sipas nenit 8.3 (dispozita Kalimtare) të rregullores së Autorizimit të Përgjithshme është përcaktuar " *AKEP do të tërheqë licensën ekzistuese me një vendim . Nëse licensa përfshinte të drejta për dhënien e të drejtave të përdorimit të numrave dhe frekuencave, AKEP do të lëshojë një vendim që jep të njëjtat të drejta*

(*autorizim individual*), për të përdorur keto numra dhe frekuenca për të njëjtën periudhë kohe si më pare dhe sipas të njëjtave kushte".

- Në pikën 2 të VKD nr. 1014, Aneksi 1, përcaktohe përdorimi i frekuencave për lidhjet fikse në brezin 18 Ghz (frekuencat 18.221/19.229 MHz).

- Licenca e mëparshme nr. 233/0303 datë 21.03.2003 e lejonte operatorin Mobitel WLC të përdorte edhe frekuencat 3.4 -3.6 Ghz, ndërkohë që sipas VKD nr.1014, Mobitel WLC nuk është më i autorizuar për përdorimin e kësaj frekuence.

- Sipas nenit 65/2 të ligjit nr. 9918, e drejta e përdorimit të frekuencave kufizohet vetëm në rast se kjo kushtëzohet nga pamjaftueshmeria e frekuencave dhe nga detyrimi për të siguruar përdorimin eficient të tyre.

Bazuar në sa më sipër, dhe në zbatim të neneve 137,140 të KPrA, ligjit nr. 9918, VKD nr.1014,date 26.12.2008,pika 4, Mobitel WLC i kërkon AKEP:

- rishqyrtimin e VKD nr.1014, duke i njohur Mobitel WLC të drejtën e përdorimit të frekuencave në brezin 3.4GHz -3.6GHz.

- përfshirjen në Autorizim Individual të frekuencave në brezin 3.4GHz -3.6GHz.
- 6. Për trajtimin e ankimit të Mobitel WLC KD janë administruar:
 - Shkresa e ERT, Qershor 2004, drejtuar operatorit Mobitel Wireless Communications “*Mbi përdorimin e frekuencave në brezin 3.4-3.6GHz deri në fund të vitit 2005*”.
 - VKD i ERT nr.194.
 - Shkresa e ERT nr.1594, datë 26.10.2004, drejtuar Mobitel Wireless Communications “*Mbi përdorimin e frekuencave të bandes 3.4-3.6 GHz*”.
 - Shkresa e Mobitel WLC, nr.228, datë 9.11.2004, drejtuar ERT-së.
 - Shkresa e ERT, viti 2005, drejtuar Mobitel WLC “*Mbi licensën nr.233/0303 e modifikuar më datë 19.11.2004*”
 - Shkresa e Drejtorisë së Licensimit në ERT, më datë 5.01.2006 “*Mbi kërkesën e Mobitel WLC sh.a*”.
 - Shkresa e ERT, më datë 13.01.2006, drejtuar Mobitel WLC sh.a “*Mbi aplikimin Tuaj për licensë ISP kombëtare*”.
 - Shkresa e MPPTT, nr.8490, datë 14.08.2006, drejtuar ERT “*Dërgohet projekt-vendim për mendim*”.
 - Shkresa e ERT, nr.1574/1, datë 31.08.2006 “*Përgjigje Tuajes nr.8490, datë 14.08.2006, “Projekt-Vendim për mendim” drejtuar MPPTT-së.*”
 - Shkresa e ERT, nr.769, datë 21.03.2007 “*Për ndërprerjen e përdorimit të radiofrekuencave të brezit 3.4-3.6 GHz*”, drejtuar Mobitel WLC.
 - Shkresa e Veve Group, nr.13, datë 27.03.2007 drejtuar MPPTT-së “*Ankesë për mospërdorim të frekuencave 3.4- 3.6 nga MobitelWLC*”
 - Shkresa e MPPTT, nr.2129/1, datë 5.4.2007 “*Mbi ankesën e VEVE Group*”, drejtuar ERT.
 - Shkresa e ERT, nr.769/4, datë 19.04.2007, drejtuar MPPTT-së “*Informacion në lidhje me çështjen e radiofrekuencave të operatorit MobitelWLC*”.
 - Shkresa e ERT, nr.1676/2, datë 12.09.2007 “*Mbi aplikimin Tuaj për modifikimin e licensës nr.233/0303*”, drejtuar Mobitel WLC .
 - Shkresa e Veve Group, nr.61/2, datë 11.12.2007 “*Në lidhje me licensën e përdorimit të frekuencave të brezit 3.4-3.6 GHz*”, drejtuar ERT, MPPTT dhe Kryeministrit.
 - Shkresa e Mobitel WLC, nr.941, datë 27.03.2008 “*Propozim për zgjidhjen e problemit që lidhet me Licensën për përdorimin e brezit të frekuencave 3.4-3.6 GHz*”, drejtuar ERT.
 - Shkresa e ERT, nr.941/1, datë 2.4.2008 “*Lidhur me largimin nga përdorimi i brezit 3.4 - 3.6GHz*”, drejtuar Mobitel WLC .
 - Shkresa e Mobitel WLC, datë 15.04.2008 “*Propozim për të zgjidhur problemin referuar licensës për përdorimin e brezit 3.4-3.6*”, drejtuar ERT.
 - Shkresa e ERT, nr.1109/1, datë 29.04.2008 “*Mbi përdorimin e radiofrekuencave të brezit 2570-2620 Mhz*”, drejtuar Mobitel WLC.
 - Shkresa e Mobitel WLC, nr.97, datë 29.05.2008 “*Detaje të propozimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes mbi licensën për përdorim të brezit të frekuencave 3.4-3.6*”, drejtuar ERT.
 - Shkresa e Mobitel WLC, nr.106, datë 20.06.2008 “*Informacion në lidhje me propozimin për licens*” drejtuar ERT.
 - Shkresa e Dr.Rreg.TeknikAKEP, nr.941/4, datë 24.06.2008 “*Mbi shkresën nr.941/3 dt.20.06.2008 të Mobitel WLC*”, drejtuar Drejtorisë së Inspektimit dhe Monitorimit AKEP.
 - Shkresa e MPPTT nr.3956/1, date 10.07.2008 “*Mbi problemin e ngritur nga Mobitel WLC*”, drejtuar AKEP.
 - Shkresa e Drejtorisë së Insp. Monitorimit AKEP, nr.1770/1, datë 25.7.2008 “*Mbi trajtimin e praktikës së Mobitelit WLC*”, drejtuar Drejtorit Ekzekutiv.
 - Shkresa e Dr.Rreg.Teknik AKEP, nr.1770/2, datë 29.07.2008 “*Mbi shkresën nr.1770/1, dt 25.07.2008 për çështjen e Mobitel WLC*”, drejtuar Drejtorit Ekzekutiv.
 - Shkresa e Drejtorisë Juridike AKEP, nr.1770/3, datë 29.07.2008 “*Mbi trajtimin e praktikës së Mobitel WLC në shkresën nr.1770/1*”
 - Minutat e takimit AKEP-Mobitel WLC në AKEP më datë 10.09.2008.

- Shkresë e Mobitel WLC , nr.125, datë 11.09.2008 “*Propozimi final në lidhje me vendimmarrjen në diskutim mbi licensën 3.5 GHz për Mobitel WLC*”, drejtuar MPPTT.
- Shkresë e Drejtorisë së Insp. Monitorimit AKEP, nr.2329/1,datë 15.09.2008 “*Informacion mbi takimin me Mobitel WLC*”, drejtuar Drejtorit Ekzekutiv.
- Shkresë e MPPTT, nr.6506/1, datë 17.09.2008 “*Mbi propozimin final te Mobitel WLC në lidhje me vendimmarrjen në diskutimin mbi licensën në brezin 3.5GHz*”, drejtuar AKEP.
- Shkresë e Drejtorisë së Insp. Monitorimit dhe Dr. Rreg.Teknik, nr.2329/3, datë 06.10.2008 “*Përgjigje shkresës nr.2329/2, dt.18.09.2008 mbi propozimin final të Mobitel WLC*”, drejtuar Drejtorit Ekzekutiv.
- Shkresë e anëtarit të Këshillit Drejtues AKEP, nr. 2329/4, datë 08.10.2008 “*Përgjigje të shkresës nr 2329/2, datë 18.09.2008, për propozimin final të Mobite lWLC*”, drejtuar Kryetarit të KD-së.
- Njoftim i Mobitel WLC për Fillimin/Ndryshimin/Mbylljen e ofrimit të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, datë 16.10.2008, drejtuar AKEP.
- Shkresë e Mobitel WLC nr.134/1,datë 17.10.2008 “*Mbi njoftimin sipas Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm*”, drejtuar AKEP.
- Shkresa e AKEP, datë 22.10.2008 “*Konfirmim i njoftimit sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm*”, drejtuar Mobitel WLC.
- Shkresa e AKEP, nr. 2732/1, datë 22.10.2008 “*Mbi njoftimin Tuaj sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm*”, drejtuar Mobitel WLC.
- Shkresë e Drejtorisë së Insp. Monitorimit dhe Dr. Rreg. Teknik AKEP, nr.2329/5,datë 22.10.200 “*Lidhur me propozimin për zgjidhjen e kërkesës së Mobitel WLC*”, drejtuar Drejtorit Ekzekutiv.
- Shkresë e Mobitel WLC, nr. 216,datë 14.10.2009 “*Licensa e Mobitel WLC nr.233/0303, e modifikuar*”, drejtuar AKEP.
- Vendim i Këshillit Drejtues të AKEP, nr.1008, datë 28.10.2009 “ *Pë hyrjen në fuqi të disa vendimeve për transpozimin e licensave të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike*”.
- Shkrese e Mobitel WLC, nr. 228, datë 3.12.2009 “*Ankim kundër vendimit nr.1014, datë 26.12.2008 “Për transpozimin e Licenses se Klasit II Nr.233/0303, modifikuar dt.21.03.2003, modifikuar dt.19.11.2004, të subjektit Mobitel Wireless Communications sh.a*”, drejtuar AKEP.
- Shkresë e Dr.Licensimit AKEP, nr. 4577/1, datë 22.12.2009 “*Mbi shkresën nr.457 , datë 3.12.2009 të sipërmarrësit Mobitel WLC*”, drejtuar Drejtorisë Juridike.

7. ERT/AKEP, në mënyre të vazhdueshme në vite e ka njoftuar dhe paralajmëruar zyrtarisht sipërmarrësin Mobitel WLC për largimin nga brezi 3.4-3.6 GHz, bazuar në VKM nr. 288, ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.692, date 27.12.2002, si dhe Vendimin e Këshillit Drejtues nr.194,datë 25.06.2004, dhe se e konsideron të lirë këtë brez.

8. Mobitel WLC, e ka kundërshtuar në mënyrë të përsëritur vendimin dhe qëndrimin e ERT/AKEP duke kërkuar në këmbim të largimit nga brezi 3400-3600 MHz, ti jepet në përdorim brezi 2570-2620 MHz.

9. AKEP, nuk e ka pranuar kushtin e propozuar nga sipërmarrësi duke argumentuar zyrtarisht se e administron dhe e jep në përdorim spektrin e frekuencave bazuar ne ligjin nr.9918, datë 19.05.2008, Planin Kombëtar të Radiofrekuencave - PKRF (miratuar me VKM nr.379, datë 31.5.2001,i ndryshuar), dhe rekomandimeve të ITU dhe CEPT/ECC.

- Sipas përcaktimeve të PKRF, brezi 2500-26090 MHz, në të cilin përfshihet brezi i frekuencave 2570-2620 MHz është i caktuar për përdorim për ngritjen e rrjeteve UMTS/IMT- 2000.

10. Duke qene se sipërmarrësi Mobitel WLC është i pajisur tashmë me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave në brezin 18 GHz për lidhjet fikse siç përshkruhet në Aneksin nr.1, me afat deri më 21.03.2013, sipas VKD nr.1014, këtij sipërmarrësi nuk mund t'i jepen për përdorim brezat 2500 MHz, të cilët shërbejnë për ofrimin e shërbimit publik telefonik të levizshëm.

11. Brezi i frekuencave 3.4 - 3.6 GHz është caktuar për shërbime publike telekomunikacioni dhe do të jepet në përdorim pas përfundimit të studimit që ka ndërmarrë AKEP. Bazuar në VKM nr. 288, ndryshuar me VKM nr.692, datë 27.12.2002, në përfundim të këtij studimi frekuenca të brezit të mësipërm të frekuencave do të jepen me procedure tenderi publik.

Në zbatim të VKD nr.1031,datë 20.11.2009,është në zhvillim e sipër procedura e Konsultimit Publik për dhënien në përdorim të frekuencave BWA, me afat deri me 30.12.2009. Në vijim, mbi bazën e rezultateve të këshillimit publik do të veprohet sipas përcaktimeve të parashikuara në pikën 5 të nenit 68 të ligjit nr. 9918.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli Drejtues i AKEP në zbatim të nenit 146 germa “a” të ligjit Nr.8584 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, pikës 1 e nenit 114 dhe nenit 115 të ligjit nr. 9918, ligjit nr. 8480, si dhe pikës 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S I :

1. Lënien në fuqi të Vendimit të Këshillit Drejtues nr.1014, datë 26.12.2008 “Për transpozimin e Licenses së Klasit II Nr.233/0303, modifikuar dt.21.03.2003, modifikuar dt.19.11.2004, të subjektit MobitelWireless Communications sh.a “ dhe rrezimin e ankimit administrativ nr.228 Prot, datë 3.12.2009, të sipërmarrësit Mobitel WLC.
2. Ky vendim hyn ne fuqi datën e miratimit të tij.

Vendimi është i ankimueshëm në rrugë gjyqësore sipas pikës 3 të nenit 137 të KPrA dhe nenit 324 e vijues të Kodit të Procedurave Civile në Republikën e Shqipërisë.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

A N E T A R E T:

1. **Alketa Mukavelati** _____
2. **Benon Paloka** _____
3. **Ipsen Elezi** _____
4. **Zamira Nurce** _____